

REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

1725/Prot.
3

Tiranë, më 03.07.2014

DREJTUAR : UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"

KORÇË

LËNDA : PËR PËRFUNDIMET E MISIONIT TË AUDITIMIT

Nga data 17.03.2014 deri në datën 28.03.2014, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ka zhvilluar një mision auditimi në Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, me objekt "Auditim i plotë duke bërë vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e riskut, dhënien e rekomandimeve dhe këshillave për përmirësimin e sistemeve në arritjen e objektivave", për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2013.

Bashkëngjitur ju dërgojmë:

- Raportin final të auditimit
- Formatin standard "Anketa për reagimet nga auditimi"

Gjatë realizimit të këtij misioni, grupi i auditimit ka konstatuar gjetjet e mëposhtme:

- Nuk është realizuar një detyrë e lënë nga auditimi i mëparshëm konkretisht:
 - Detyra, "Të arkëtohen pagesat që janë bërë për mësues mentor, në shumën prej 2 025 000 lekë pa bazë ligjore", kjo detyrë nuk është realizuar sepse, sipas Urdhrit nr. 2 të Rektorit, datë 15.01.2013, është njoftuar DAR Korçë me shkresën nr. 3/31prot, datë 05.02.2013 për arkëtimet nga 60 mësuesit mentor me shumat përkatëse, ndërsa DAR Korçë, me shkresën nr. 28 prot, datë 08.01.2014, njofton Universitetin se nuk mund të plotësojë kërkesën e tij.
- Nga auditimi i dokumentacionit të emërimeve të reja rezulton se, 22 punonjës akademik nuk plotësojnë kriterin e diplomës, sipas përcaktimeve në Kreun II, pika 3 të VKM-së nr. 331, datë 25.03.2009 dhe paragrafit të tretë të nenit 89, të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, atëherë, këta punonjës akademik janë emëruar me kontratë 1-vjeçare deri në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në aktet e sipër cituara.
- Në kundërshtim me, VKM-në nr. 331, datë 25.03.2009 "Për ndarjen në nivele, brenda kategorive të personelit akademik në IAL, emërtimin dhe renditjen e tyre, si dhe kriteret dhe kualifikimet për secilin vend pune", Kreu II, pika 5, vendet e lira për personelin akademik të punësuar, nuk janë shpallur në muajin Qershor të çdo viti.
- Për vitin 2013, janë emëruar tri punonjës pa procedura konkurrimi, si dhe duke mos zbatuar shkresën nr. 363 prot, datë 17.10.2013 të MAS-it "Lidhur me rekrutimet e



personelit akademik në IPAL”, shkresë e cila pezullon rekrutimet për personel akademik me kohë të plotë në të gjitha IALP.

- Sektori i marrëdhënieve me jashtë, është krijuar në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 474, datë 16.6.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”, pika 27, i cili rekomandon që; “Funksionet e marrëdhënieve me jashtë nuk organizohen si njësi organizative e veçantë, ky funksion duhet kryhet nga drejtuesit e njësive administrative të institucionit ose nga titullari i tij.”
- Për sistemin part-time, rezultojnë të paguara gjithsej 801 orë mësimi me vlerë 583.800 lekë, nga 14 punonjës akademik dhe akademik drejtues, kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në IPAL” pika 2, germa c (mbështetje për institucionin), sipas misionit që ka dhe përshkrimit të vendit punës, pik 4.2 dhe pika 8.
- Në dosjet e dokumenteve për ambientet e dhëna me qira, u konstatuan këto mangësi;
 - nuk u gjet konfirmimi i genplanit të lëshuar nga organi i Prefekturës kjo në kundërshtim me “Për procedurat e dhënies me qira të pasurisë shtetërore” Kap.II. pika ç.
 - nuk është marrë konfirmimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për pronësinë “shtet” të objektit, si dhe nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për vendimet që mundë të kenë dhënë për njohje apo kthim prone, kjo në kundërshtim me “Procedurat e dhënies me qira të pasurisë shtetërore” Kap.II, germa e.

Bazuar në gjetjet e konstatuara, të trajtuara gjatë procesit të auditimit, të evidentuara në projekt-raport dhe në raportin final të auditimit, për përmirësimin e punës në të ardhmen, mbështetur në kërkesat e Ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", të ndryshuar, në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me auditimin e brendshëm,

URDHËROJ:

Të realizohen masat si më poshtë:

I.- Masa organizative:

1. Në të ardhmen, shpallja e vendeve të lira për personel akademik, të bëhet në muajin Qershor të çdo viti akademik, sipas kërkesave të VKM-së nr. 331, datë 25.03.2009 “Për ndarjen në nivele, brenda kategorive të personelit akademik në IAL, emërtimin dhe renditjen e tyre, si dhe kriteret dhe kualifikimet për secilin vend pune”, Kreu II, pika 5.
2. Të shpallen vende të lira pune dhe të kryhen procedurat e konkurrimit për pozicionet e punës së punonjësve akademik:
 - Liri Seitllari
 - Eriseld Kalemaj

të cilët janë emëruar në kundërshtim me shkresën nr. 363 prot, datë 17.10.2013 të MAS-it “Lidhur me rekrutimet e personelit akademik në IPAL”, pa zhvilluar procedura konkurrimi.



3. Të suprimohet "Sektori i marrëdhënieve me jashtë", funksionet e tij të kryhen nga drejtuesit e strukturave të institucionit ose nga titullari i tij, sipas kërkesave të përcaktuara në VKM-në nr.474, datë 16.06.2011, "Për përcaktimin e Standardeve e procedurave që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike", pika 27.
4. Të gjitha praktikat e dhënies me qira të objekteve, të plotësohen me dokumentacionin përkatës, nga strukturat e Prefekturës, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, dhe nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo në zbatim të "Procedurave të dhënies me qira të pasurisë shtetërore", Kap.II, pika ç, germa e.

II.- Masa zhdëmtimi :

1- Të merren masat dhe të ndiqen procedurat në rrugë ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën prej **583,800** lekësh, nga stafi akademik, sipas tabelës në pikën e II-të të raportit, për kryerjen e pagesave jashtë kohës normale të punës me orë administrative në kundërshtim me Udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik në IPAL", pika 2, germa c, pika 4.2 dhe pika 8".

Në zbatim të gërmas "b" të nenit 11 dhe të pikës 4 të nenit 18 të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", të ndryshuar. Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, të marrë masa të plota për zbatimin e masave, sipas kësaj shkrese si dhe të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, mbi realizimin e tyre, herë pas here sipas afateve të përcaktuara.

LINDITA NIKOLLA



MINISTËR

